



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1482 Prot.

Tiranë, më 24.07. 2026

V E N D I M Q A R K U L L E S

Nr. 114 dt. 24.07 2026

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 98 DATË 01.07.2026 “PËR MIRATIMIN E
HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT MASTER I
SHKENCAVE NË “REHABILITIM TË PROFESIONEVE TË SHËNDETIT” MIDIS
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË
REHABILITIMIT DHE UNIVERSITETIT “MAGNA GRECIA” TË KATANZAROS NË
ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr.89 datë 01.07.2026, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr.5049 Prot., datë 30.06.2026 “Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve”, shkresën nr. 76/9 prot., datë 01.07.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit “Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të përbashkët të studimit Master i shkencave në “Rehabilitimi të profesioneve të shëndetit”, Vendimin e Senatit nr. 98 datë 01.07.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Vendimit nr. 98 datë 01.07.2026 “Për miratimin e hapjes së Programit të Përbashkët të studimit Master i Shkencave në “Rehabilitim të Profesioneve të Shëndetit”, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit “Magna Grecia” të Katanzaros në Itali”, në pikën 2 të tij sipas këtij

përcaktimi: *"Programi i Përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe italiane, përkatësisht me kodet P72MS0915A dhe P72MS0915I"*.

2. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

